



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË EKONOMISË PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Ekonomisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Ekonomisë (ME), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkuara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Ekonomisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Vlera e pasurisë e prezantuar në PVF nuk ishte e saktë dhe e plotë pasi që pasuria kapitale mbi 1,000€ ishte mbivlerësuar për 7,669,939€, përderisa në anën tjetër ishte nënvlerësuar për 42,234€.
- B1 ME gjatë vitit 2021 kishte realizuar pagesa në vlerë 93,435€ për 18 punonjës (të angazhuar me Marrëveshje të Brukselit) të cilët nuk evidentohen për vijueshmërinë në punë dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në Ministri.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ME kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zv. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zv. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Ekonomisë .

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Ekonomisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Ekonomisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Ekonomisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Ekonomisë .
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Kontrollet sa i përket menaxhimit financiar gjatë vitit 2021 kanë qenë efektive, megjithatë ende nevojiten veprime shtesë për një menaxhim financiar dhe kontroll të mirëfilltë. Fusha kryesore ku nevojiten përmirësime mbetet fusha e pasurisë ku në disa raste kemi vërejtur mangësi në menaxhimin e pasurisë dhe kjo ka ndikuar në prezantim jo të saktë dhe të plotë të pasurisë në PVF, si dhe fusha e pagave sa i përket vijueshmërisë në punë të zyrtarëve të angazhuar me marrëveshje të Brukselit.

Gjetjet dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me katër rekomandime, prej tyre tri janë rekomandime të reja dhe një rekomandim i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Prezantim jo i saktë i pasurisë në PVF

Gjetja

Neni 6.1 i Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore, përcakton që: Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu, sipas nenit 6.3 - Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria". Më tutje, neni 22.1 përcakton që: Zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë.

Nga testimet e kryera në fushën e pasurisë, kemi identifikuar se vlera e pasurisë e prezantuar në PVF nuk ishte e saktë dhe e plotë pasi që pasuria ishte mbivlerësuar për 7,669,939€, përderisa në anën tjetër ishte nënvlerësuar për 42,234€, parregullsitë janë si në vijim:

- Ndërtesa në vlerë neto 7,656,844€ e N.P "Kompania Rajonale e Ujësjetësimit Mitrovica Sh.A", ende figuron në regjistrat e pasurisë së ME-së[4].
- Shpenzime të internetit në vlerë 9,995€ ishin regjistruar si pajisje e IT-së.
- Pesë pajisje GPS në vlerë 3,100€ (me çmim për njësi 620€) ishin regjistruar në regjistrin në SIMFK edhe pse nuk janë pasuri kapitale. Të njëjtat ishin regjistruar edhe në sistemin e-pasuria.
- Një pajisje në vlerë 4,600€ për Laboratorin e Shërbimit Gjeologjik

nuk ishte regjistruar në SIMFK si dhe dy pasuri jo kapitale në vlerë 2,982€, të blera gjatë vitit 2021 (furnizime me kompjuter dhe mobile) nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria.

- Pasuria kapitale “Furnizim me pajisje SEM për laboratorin e Shërbimeve gjeologjike të Kosovës” me vlerë bruto prej 498,987€ ishte zhvlerësuar duke aplikuar datën e nënshkrimit të kontratës dhe jo datën e pranimit të mallit dhe kjo ka ndikuar që vlera e kësaj pasurie të nënvlerësohet për 34,652€.

Mangësitë e identifikuar ishin rezultat i funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Prezantimi jo i drejtë dhe jo i saktë i pasurive në pasqyrat financiare vjetore dhe në regjistrat e pasurisë ndikon në vendimet e përdoruesve të informacioneve dhe në keq menaxhimin e saj.

Rekomandimi A1

Ministrja duhet të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë si dhe azhurnimin e regjistrave me qëllim që shpalojë në Raportin Vjetor Financiar për vitin 2022 të jenë të sakta dhe të prezantojnë pamje të drejtë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mungesa e evidencave për vijueshmërinë në punë

Gjetja

Neni 8 i “Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve”, përcakton se “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik“. Me vendimin nr. 06/39 të datës 22.07.2015, Qeveria e Kosovës ka aprovuar konkluzionet e dakorduara të Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për realizimin e marrëveshjes së ashtuquajtur “Mbrojta Civile”.

Në kuadër të kësaj marrëveshje për integrim, në Ministrinë e Ekonomisë përmes akt-emërimeve janë të punësuar 18 punonjës të komunitetit serb të cilët marrin paga të rregullta. Sipas konfirmimeve nga zyrtarët e Ministrisë këta të punësuar nuk kanë hapësira të përcaktuara të punës dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në Ministri. Buxheti i shpenzuar për pagat e tyre për vitin 2021 ishte 93,435€.

Kjo dukuri po vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse në vazhdimësi po raportohet në raportet tona të auditimit. Ministria ende nuk ka arritur të ndërmer masa konkrete në sistemin, angazhimin dhe monitorimin e kësaj kategorie të të punësuarve.

Ndikimi

Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmive për vijueshmërinë në punë dhe në mungesë të angazhimit për kryerjen e detyrave zyrtare, konsiderohen si pagesa të parregullta dhe dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi B1 Ministrja duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Sipas RVF të ME-së për vitin 2021, vlera neto e pasurisë kapitale ishte 33,624,976€, vlera e pasurive jokapitale 34,781€, si dhe vlera e stoqeve 36,952€.

Çështja A2 - Mos-Harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë

Gjetja Neni 19 paragrafi 4.3 i Rregullores nr. 02/2013 – Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore përcakton që: Përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe “Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.”

Komisioni për inventarizimin e pasurisë përkundër që kishte kryer me kohë inventarizimin për vitin 2021 dhe kishte përpiluar një raport gjithëpërfshirës nuk kishte harmonizuar gjendjen e inventarizuar me regjistrat e pasurive jo financiare.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrollit jo të mirë që ky proces të përfundohej para përgatitjes së pasqyrave.

Ndikimi Mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël rrit rrezikun që pasuritë të keqpërdorën, humben apo të tjetërsohen, si dhe vlera e pasurisë së organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e drejtë.

Rekomandimi A2 Ministrja duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korigjuar gabimet e mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundoj para përgatitjes së PFV për vitin 2022.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja Neni 11 paragrafi 1 dhe 3 i Rregullores nr. 02/2013 – Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore përcakton që: “Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim. Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësisë të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi. Poashtu neni 12 i kësaj rregullore përcakton që: Organizatat mund të blejnë dhe ndërtojnë pasuri përmes bashkëfinancimit dhe deri në momentin e pranimin të pasurisë jo financiare, ato do të regjistrojnë në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e pranimin nga ana e OB, atëherë kategoria e investimeve në vijim mbyllet edhe në regjistrat e OB-së

pranuese dhe OB-së bashkë financuese. Pasuria më pas regjistrohet në regjistrin e pasurisë së OB-së pranuese.

- ME vazhdon t'i mbajë si investime në vijim projektet kapitale^[5] të cilat kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i tyre, këto projekte ishin realizuar në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren. Vlerë totale e tyre ishte 2,724,523€. Sipas zyrtarëve përgjegjës në ministri kjo kishte ndodhur për shkak se ME ka paqartësi lidhur me pronësinë e këtyre pasurive dhe ende nuk është definuar nëse këto pasuri duhet të barten apo të mbeten pronë e ME-së.
- Po ashtu, ME vazhdon t'i mbajë si investime në vijim edhe tri projekte ^[6] kapitale të realizuara për organizatat tjera buxhetore, edhe pse ishin përfunduar dhe ishte bërë pranimi teknik i tyre nga komisionet përkatëse. Vlera totale e tyre ishte 1,315,456€.
- Gjashtë pajisje të Laboratorit të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës në vlerë 35,475€ të pranuar në muajin tetor të vitit 2020, ishin regjistruar si investim në vijim dhe si rezultat i kësaj nuk ishte llogaritur zhvlerësimi në vlerë 6,898€.

Mangësitë e identifikuar ishin rezultat i funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Mos definimi i pronësisë së pasurive të investuara nga ME dhe mbajtja e tyre si investime në vijim ndikon në prezantimin jo të drejtë të pasurisë. Më tutje paqartësitë mbi pronësinë e investimeve krijojnë parakushte për parregullsi dhe keqmenaxhim.

Rekomandimi A3

Ministrja duhet të sigurojë që për të gjitha investimet e realizuara në "Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve" në Prizren dhe për projekte tjera të ngjajshme të definohet pronësia e investimeve dhe njëherësh për pronat të cilat i takojnë institucioneve tjera të kryhen të gjitha procedurat e nevojshme lidhur me bartjen e pronësisë në mënyrë që gjendja e pasurisë të prezantohet saktë si dhe të evitohet mundësia për keqmenaxhim të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	82,902,177	76,386,118	64,241,822	209,948,797	25,698,493
Grante Qeveritare – Buxheti	33,994,320	58,775,400	57,890,943	167,149,191	21,113,353
Financimi përmes huamarrjes	9,226,120	8,826,120	2,801,997	6,103,137	3,638,048
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	34,681,737	8,784,598	3,548,882	84,843	0
Te hyrat nga AKP-ja	5,000,000	0	0	36,496,366	947,092
Donacionet e jashtme	0	0	0	115,260	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 6,516,059€. Ky ndryshim në masë të madhe vjen me rishikim të buxhetit si rezultat i ndryshimeve strukturore që kanë ndodhur në “Ministrinë e Ekonomisë” në vitin 2021 e cila në fillim të vitit ka funksionuar si “Ministri e Ekonomisë dhe Ambientit”. Rrjedhimisht ky zvogëlim nuk paraqet shkurtim të fondeve për aktivitetet e ME-së por ri-destinimin e tyre në sektorët përkatës sipas ri-strukturimit të ri të Organizatave Buxhetore. Poashtu në ndryshimin buxhetor kishin ndikuar edhe vendimet e ndryshme nga qeveria për ndarje, kursime dhe rregullime buxhetore.

Në vitin 2021 ME kishte shpenzuar 64,241,822€ apo 84% të buxhetit final. Në këtë përqindje të realizimit ka ndikuar niveli jo i kënaqshëm i realizimit të fondeve të ndara nga Huamarrja dhe Klauzola e Investimeve.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	82,902,177	76,386,118	64,241,822	209,948,797	25,698,493
Pagat dhe mëditjet	3,377,333	1,208,881	1,208,881	3,098,436	1,277,879
Mallrat dhe shërbimet	5,241,470	2,883,114	997,848	11,171,517	2,053,421
Komunalitë	163,430	8,364	7,783	64,553	12,961

Subvencionet dhe transferet	13,731,207	55,701,018	53,312,839	157,705,430	14,731,512
Investimet Kapitale	60,388,738	16,584,740	8,714,471	37,908,862	7,622,721

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike të buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,168,452€ dhe ky zvogëlim ishte rezultat i rishikimit buxhetor pas ndryshimit strukturor të ministrisë në vlerë prej 2,156,254€ dhe vendimeve të Qeverisë për kursime në shumë prej 12,198€.

Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,358,356€ dhe ky zvogëlim ishte rezultat i rishikimit të buxhetit në vlerë 2,238,863€ dhe vendimeve të Qeverisë për kursime në vlerë 119,493€. Në këtë kategori kemi një përqindje relativisht të ulët të shpenzimit ku buxheti është realizuar vetëm 35%. Kjo përqindje ishte rezultat i shpenzimit të ulët të burimeve të financimit nga huamarrja për shkak të shtyerjes së projekteve si pasojë e kufizimeve që ka krijuar situata me COVID -19.


Buxheti final për shpenzime komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 155,066€ dhe ky zvogëlim ishte rezultat i rishikimit të buxhetit në vlerë 123,430€ dhe vendimeve të qeverisë në vlerë 31,636€. Ky ndryshim i theksuar i buxhetit në këtë kategori ka ardhur si rezultat i mbulimit të disa shpenzimeve nga departamenti përkatës i inxhinierisë së ish MAP.

Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 41,969,811€. Kjo rritje ishte rezultat i rishikimit buxhetor në vlerë 5,644,557€ dhe vendimeve të qeverisë për ndarje, kursime dhe rregullime të brendshme në vlerë 36,325,254€. Prej mjeteve të ndara me vendime të qeverisë, 20 milion€ ishin destinuar për tejkalimin e krizës energjetike, ndërsa pjesa tjetër për mbështetje të ndërmarrjeve publike.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 43,803,998€. Ky zvogëlim ishte rezultat i rishikimit buxhetor në vlerë 41,811,483€ dhe vendimeve të qeverisë në vlerë 1,992,515€. Në këtë kategori buxheti ishte realizuar vetëm 53%. Arsyet e mos-realizimit të buxhetit kishin të bënin me shtyrjen e projekteve të financuara me Klauzolën e investimeve për shkak të kufizimeve të krijuara nga situata me pandeminë COVID-19.

Sa i përket shpenzimit të mjeteve nga "Programi i rimëkëmbjes ekonomike", ME kishte shpenzuar mjete në vlerë prej 41,860,000€ nga kategoria subvencione dhe transfere.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Në totalin e shpenzimeve të realizuara në vitin 2021, subvencionet dhe transferet përbëjnë 83% të shpenzimeve, investimet kapitale 14%, mallra dhe shërbimet përfshirë komunalitë 1% si dhe pagat dhe mëditjet 2%.

Të hyrat e realizuara nga ME në vitin 2021 ishin 2,400€. Këto të hyra kanë të bëjnë me shërbimet që ofron Inspektorati i Energjisë pranë Ministrisë së Ekonomisë përkatësisht dhënia e autorizimeve për bizneset që bëjnë kontrollin e pajisjeve në presion në tërë territorin e Kosovës. Për shkak të ndryshimeve strukturore që ka pësuar Ministria gjatë vitit projeksioni dhe analiza ndër vite nuk është e krahasueshme.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	2,400	1,157,999	1,318
Të hyrat jo tatimore	0	0	2,400	1,157,999	1,300
Të hyrat tjera	0	0	0		18

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Struktura organizative e Ministrisë së Ekonomisë (ME) në vitin 2021 ka pësuar ndryshime me hyrjen në fuqi të “Rregullores (qrk) - nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive” me të cilën është themeluar Ministria e Ekonomisë, e cila në vitin paraprak kishte funksionuar së bashku me ish Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si “Ministri e Ekonomisë dhe Ambientit” (MEA).

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2020 ka rezultuar me 17 rekomandime kryesore. Për shkak të ndryshimeve strukturore që i ka pësuar Ministria në vitin 2021, rekomandimet në raportin e vitit paraprak i janë dhënë Ministrive sipas përgjegjësisë përkatëse. Nga 17 rekomandime, 8 prej tyre ishin dhënë për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe infrastrukturës, një rekomandim është dhënë për Ministrinë e Ekonomisë dhe 8 rekomandime tjera janë dhënë të përbashkëta për të dy ministritë. Rrjedhimisht nga 9 rekomandime që e kanë përfshirë ME-në deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, 4 rekomandime ishin zbatuar, 1 rekomandim nuk ishte zbatuar dhe 4 të tjera nuk janë të aplikueshme më për ME pas ndryshimeve strukturore të ministrisë.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojë monitorimin e procesit të raportimit për shfrytëzimin e sasive të ujit nga kompanitë, që të mund të sigurojë faturimin e sasisë së ujit të shfrytëzuar në bazë të tarifave të përcaktuara sipas kornizës ligjore.	Ky rekomandim i takon MMPHI dhe nuk është i aplikueshëm më për ME.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Të hyrat	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet t'i identifikoj të gjithë faktorët që kanë shkaktuar vonesat në funksionalizimin e këtij sistemi dhe t'i	Ky rekomandim i takon MMPHI dhe nuk është i aplikueshëm më	Nuk është i aplikueshëm më

		ndërmarrë veprimet e nevojshme për tejkalimin e tyre, si dhe të siguroj se brenda një periudhe të arsyeshme, sistemi të jetë në përdorim me të gjitha informatat dhe me mundësi të qasjes së publikut.	për ME.	
3.	Pagat mëditjet dhe	Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojë krijimin e kushteve të punës për të gjithë punonjësit e saj si dhe të bëjë monitorimin e rregullt të vijueshmërisë në punë dhe në rastet e mos respektimit të orarit të punës të merren masa konkrete siç parashihen me kornizën e aplikueshme ligjore.	Ministria kishte vazhduar t'i paguaj ish pjesëtar të Mbrojtjes Civile edhe pse të njëjtit nuk kanë vijuar punën as gjatë vitit 2021.	Nuk është adresuar
4.	Investimet kapitale	Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojnë se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit 30 ditor nga pranimi i faturës ose kërkesës për pagesë, në mënyrë që të shmangen pagesat direkte nga Thesari dhe pagesat me procedura përmbimore apo gjyqësore.	Këtë vit nuk kemi hasur në raste të vonesave në pagesa në ME.	I zbatuar
5.	Investimet kapitale	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojë që pas pranimi të vendimeve nga Gjykata të siguroj kompletimin e dokumentacionit nga akterët e përfshirë në proces me qëllim që lënda të kompletohet dhe të procedohet për pagesë.	Ky rekomandim i takon MMPHI dhe nuk është i aplikueshëm më për ME	Nuk është i aplikueshëm më
6.	Investimet kapitale	Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojnë që për secilën marrëveshje caktohet zyrtari monitorues i projektit, i cili do të monitoroj të gjitha fazat e projektit deri në finalizimin e tyre.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla në ME këtë vit.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojnë funksionimin e kontrolleve dhe respektimin e rregulloreve gjatë ekzekutimit të pagesave, si dhe zbatimin e kushteve të kontratave dhe marrëveshjeve për bashkëfinancimin e projekteve.	Ky rekomandim edhe pse i është dhënë dy Ministrive edhe ME edhe MMPH, nuk është i aplikueshëm për ME pasi që të gjitha rastet e identifikuar në vitin paraprak i takonin MMPH. Ne nuk kemi idenifikuar raste të tilla në ME këtë vit.	Nuk është i aplikueshëm më
8.	Investimet kapitale	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojë bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet të gjitha palëve pjesëmarrëse në proces, që nga bërja e porosive deri të aktivitetet e kontrollit rreth realizimit të pagesave, në mënyrë që ato shpenzime të procedohen	Ky rekomandim është dhënë për MMPHI.	Nuk është i aplikueshëm më

		sipas rregullave dhe hapave të paracaktuar.		
9.	Investimet kapitale	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të rishikoj tërë procesin dhe t'i identifikoj të gjithë faktorët që kanë shkaktuar vonesat në funksionalizimin e këtij sistemi, si dhe të siguroj se brenda një periudhe të arsyeshme, sistemi të jetë në përdorim nga të gjitha institucionet.	Ky rekomandim i takon MMPHI dhe nuk është i aplikueshëm më për ME.	Nuk është i aplikueshëm më
10.	Pasuritë	Ministri i Ekonomisë të sigurojë mbikëqyrje adekuate gjatë regjistrimeve të pasurive dhe gjatë raportimeve periodike në mënyrë që të mundësohet identifikimi i gabimeve para se të përgatiten pasqyrat financiare vjetore.	Ky rekomandim ishte zbatuar. Nuk kemi identifikuar raste të mos-aplikimit të zhvlerësimit të pasurisë këtë vit.	I zbatuar
11.	Pasuritë	Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurohen që pasuritë të cilat i kanë në posedim dhe prej tyre krijojnë të hyra të shpalosen me të gjitha detajet aktuale dhe specifikat e tyre në RVF në mënyrë që përdoruesit e pasqyrave financiare të kenë informacion të plotë lidhur me përbërjen e pasurive të Ministrive.	Ky rekomandim edhe pse i është dhënë dy Ministrive (ME dhe MMPHI), nuk është i aplikueshëm për ME pasi që të gjitha rastet e identifikuar në vitin paraprak i takonin MMPH dhe nuk kanë të bëjnë me aktivitetet e ME.	Nuk është i aplikueshëm më
12.	Pasuritë	Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojnë se të gjitha pasuritë regjistrohen me kohë në SIMFK, me qëllim që vlera e pasurive jo financiare të prezantohet drejtë në RVF.	Në vitin paraprak Ministria e Ekonomisë ka funksionuar si Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit dhe rrjedhimisht rekomandimi është dhënë i përbashkët për të dy Ministrinë edhe pse rastet e identifikuar i takonin MMPH. Ne do ta mbyllim këtë rekomandim dhe në rast se identifikohen raste të tilla në ME do të hapen si çështje të reja për ME.	Nuk është i aplikueshëm më
13.	Llogaritë arkëtueshme	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të sigurojë se po bëhet monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të ujërave të Kosovës dhe në rastet kur shfrytëzuesit e ujërave operojnë pa leje	Ky rekomandim i takon MMPHI dhe nuk është i aplikueshëm më për ME.	Nuk është i aplikueshëm më

		ujore apo me leje të skaduar, të merren masa konkrete për ndalimin e veprimeve të jashtëligjshme sipas dispozitave të parapara me kornizën ligjore në fuqi.		
14.	Llogaritë arkëtueshme	e Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të siguroj se procedurat për shlyerje të borxheve po zbatohen në përpikëri dhe në rastet e mos respektimit, të marrë masa konkrete ndëshkuese ndaj KRU-ve, siç parashihet me marrëveshjet për shlyerjen e borxhit.	Ky rekomandim i takon MMPHI dhe nuk është i aplikueshëm më për ME.	Nuk është i aplikueshëm më
15.	Obligimet papaguara	e Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të sigurojnë se mbahen evidenca adekuate lidhur me obligimet e ministrisë dhe para prezantimit të shumave të bëhen verifikime dhe kontrole për t'i identifikuar dhe korrigjuar gabimet para miratimit të RVF.	Nuk kemi identifikuar asnjë rast të tillë në ME këtë vit.	I zbatuar
16.	Obligimet papaguara	e Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me akterët tjerë të ndërlidhur në këtë proces, të siguroj buxhet të mjaftueshëm për t'i kryer obligimet financiare të shpronësimeve në mënyrë që t'i shmangin ndëshkimet dhe kostot shtesë për shkak të vonesave.	Ky rekomandim i takon MMPHI dhe nuk është i aplikueshëm më për ME.	Nuk është i aplikueshëm më
17.	Auditimi Brendshëm	i Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të siguroj se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm përcillen me një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e tyre.	Në vitin paraprak Ministria e Ekonomisë ka funksionuar si Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit dhe rrjedhimisht ka funksionuar një Njësi e Auditimit të Brendshëm e përbashkët për dy Ministrinë, prandaj nuk mund të bëhet një analizë reale e gjendjes së këtij rekomandimi . Si rrjedhojë ne do ta mbyllim këtë rekomandim dhe çdo çështje që del nga NJAB do të trajtohet si çështje e re.	Nuk është i aplikueshëm më

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Arian Haxha, Drejtor i Auditimit



Fjolla Bakalli, Udhëheqëse e ekipit




Burbuqe Idrizi, Anëtare e ekipit



Natyra Kasumaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
 Vlada-Government
 Ministria e Ekonomisë
 Ministarstvo Ekonomije/Ministry of Economy

REFERENCË:	RAPORTI I AUDITIMIT		
PËR/ZA/TO:	znj. Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme/ Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës		
CC:	znj. Leonita Shabani Mullarama, Zv. Sekretare e Përgjithshme/ Ministria e Ekonomisë		
PËRMES/PREKO/THROUGH:			
NGA/OD/FROM:	znj. Artane Rizvanolli, Ministre/ Ministra e Ekonomisë		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2021		
Nr. i zyrës:	Lokacioni:	Data:	27.04.2022
Br. kancelarije:	Kuçi:	Datum:	
Room No.:	Extension:	Date:	

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

E nderuara znj. Spanca,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Ekonomisë për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Artane Rizvanolli
 Ministre e Ekonomisë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- 1 Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- 2 Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- 3 Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- 4 Kjo pasuri është bartur nga Ministria e Financave tek regjistri i pasurisë së ish MZHE-së sipas Marrëveshjes me MF në janar të vitit 2016, nën arsyetimin se KRU Mitrovica ishte organizatë buxhetore e cila nuk kishte qasje në sistemin e free balancit.
- 5 “Harduer dhe shërbime për Rrjetin Kombëtar të Kërkimit”, në vlerë 1,792,867 e pranuar tekniksht me datë 10.12.2021; “ Krijimi i Qendrës së Ekselencës Dixhitale” në vlerë 931,656€ e pranuar tekniksht me datë 22.09.2020.
- 6 Pajisje të IT për trajnime (kompjutera, multi touch screens, etj), në vlerë prej 65,110€ për Unversitetin e Mitrovicës dhe Unversitetin e Gjakovës. Pranimi teknik për këto pajisje ishte bërë me datën 26.10.2021; . Projekti “Auditimi Energjetik i ndërtesave publike” në vlerë prej 95,715€. Raporti përfundimtar për realizimin e punimeve ishte bërë me datën 08.03.2021; Projekti “Zbatimi i masave EE në Ndërtesa Publike” në vlerë prej 1,154,630€. Pranimi i përkohshëm i këtij projekti është bërë me 19.08.2021 dhe si rezultat objektet janë në përdorim dhe përfshijnë 29 ndërtesa të ndryshme që nuk janë pronë e ME-së.
- 7 Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- 8 Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- 9 Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.